



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 121

18 shtator

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 79/2012 datë 3.9.2012	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 25.7.2012 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e task-forcës për marrjen e masave të menjëhershme ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara në qendrat urbane dhe zonat turistike e bregdetare”	6839
Vendim i KM nr. 540, datë 7.8.2012	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kozarë të qarkut të Beratit.....	6839
Vendim i KM nr. 543, datë 25.7.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme, si kontribut për shoqatën “Albanian-American Association of Cleveland”, për realizimin e monumentit të Nënë Terezës dhe ndërtimin e parkut kombëtar shqiptar “Nënë Tereza”, në Kleveland, Ohio, SHBA.....	6840
Vendim i KM nr. 544, datë 1.8.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 60, datë 18.1.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2013-2015”	6841
Vendim i KM nr. 545, datë 16.8.2012	Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve e të studentëve në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2012 -2013.....	6845
Vendim i KM nr. 546, datë 16.8.2012	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.....	6851
Vendim i KM nr. 547, datë 16.8.2012	Për dhënien e bursave për nxënësit e shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, Shkodër, për vitin shkollor 2012-2013.....	6851

Vendim i KM nr. 548, datë 16.8.2012	Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, me kohë të plotë, për vitin akademik 2012-2013.....	6852
Vendim i KM nr. 549, datë 16.8.2012	Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në disa institucione publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve “Master profesional”, me kohë të plotë, për vitin akademik 2012-2013.....	6862
Udhëzim i MF nr. 17, datë 4.9.2012	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 19, datë 1.9.2011 “Për modalitetet e aplikimit të pullave të akcizës dhe pullave fiskale në produktet e duhanit, birrës dhe alkoolit”.....	6870

LIGJ
Nr. 79/2012

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 2, DATË 25.7.2012 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR MARRJEN E
MASAVE TË MENJËHERSHME NDAJ SUBJEKTEVE QË GJENEROJNË ZHURMË TEJ
NORMAVE TË LEJUARA NË QENDRAT URBANE DHE ZONAT TURISTIKE E
BREGDETARE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 25.7.2012, i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e task-forcës për marrjen e masave të menjëhershme ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara në qendrat urbane dhe zonat turistike e bregdetare”.

Miraturar në datën 3.9.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7764, datë 11.9.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

VENDIM
Nr. 540, datë 7.8.2012

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS KOZARË TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Kozarë të qarkut të Beratit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 109 (njëqind e nëntë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 724 (shtatëqind e njëzet e katër).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kozarë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

6839



Komuna Kozarë

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
10-13, 719-724	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
14	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
16-24	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në strehimin dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
25-34	Varreza publike	Në pronësi
51-53,60-09,114-191,198-362,365-379,383-405,408-472,474-477	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
479,480,482,483-488,490-496,498,500,501,503,506	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
481,489,497,499,502,504,505	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
654-658	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM

Nr. 543, datë 25.7.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME, SI KONTRIBUT PËR SHOQATËN “ALBANIAN-AMERICAN ASSOCIATION OF CLEVELAND”, PËR REALIZIMIN E MONUMENTIT TË NËNË TEREZËS DHE NDËRTIMIN E PARKUT KOMBËTAR SHQIPTAR “NËNË TEREZA”, NË KLEVELAND, OHIO, SHBA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në programin 01120 “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, t’i shtohet fondi i përgjithshëm prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, si kontribut për shoqatën “Albanian-American Association of Cleveland”, e cila do të realizojë monumentin e “Nënë Terezës”, si dhe ndërtimin e Parkut Kombëtar Shqiptar “Nënë Tereza”, në Kleveland, Ohio, SHBA.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 544, datë 1.8.2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 60, DATË 18.1.2012 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E KUADRIT MAKROEKONOMIK E FISKAL PËR
PERIUDHËN 2013-2015”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhjet nr. 1, nr. 2/1 dhe nr. 2/2, bashkëlidhur vendimit nr. 60, datë 18.1.2012 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohen me lidhjet nr. 1, nr. 2/1 dhe nr. 2/2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Lidhja Nr. 1

Treguesit kryesorë makroekonomik

Treguesit	Njësia	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
					Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	2.88	2.86	2.83	2.83	2.83	2.83	2.83
Norma e inflacionit (mesatar)	%	2.3	3.6	3.5	3.0	3.0	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	2.0	2.6	3.3	1.5	1.1	0.7	0.5
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	95.0	103.9	100.9	110.8	110.2	109.7	109.0
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	131.6	137.7	140.5	138.2	139.0	139.5	140.0
Rritja reale e PBB	%	3.3	3.8	3.1	3.0	4.0	4.2	4.5
PBB	Lek miliardë	1,148.1	1,222.5	1,301.7	1,360.9	1,430.9	1,501.5	1,576.9
PBB	USD miliardë	12.1	11.8	12.9	12.3	13.0	13.7	14.5
PBB	Euro miliard	8.7	8.9	9.3	9.8	10.3	10.8	11.3
PBB për banor	Lek mijë	398.7	428.1	459.7	480.6	505.3	530.2	556.9
PBB për banor	USD	4,197.8	4,119.2	4,555.9	4,337.5	4,585.4	4,833.4	5,108.8
PBB për banor	Euro	3,030.1	3,109.1	3,271.5	3,477.5	3,635.4	3,800.9	3,977.5
PBB për banor	USD-PPP	9,273.1	9,956.0	10,690.7	10,679.8	11,229.2	11,782.7	12,374.5
Norma e papunësisë	%	13.8	13.5	13.3	13.5	13.1	12.2	10.9
Të ardhurat totale	% të PBB	26.0	26.6	25.4	25.3	25.0	25.1	25.2
Shpenzimet totale	% të PBB	33.1	29.7	28.9	28.3	27.0	27.4	27.5
Bilanci i përgjithshëm fiskal	% të PBB	-7.0	-3.1	-3.5	-3.0	-2.0	-2.3	-2.3
Bilanci primar fiskal	% të PBB	-3.9	0.3	-0.4	0.4	1.5	1.3	1.3
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	1.3	2.4	1.9	1.6	1.4	1.3	1.1
Huamarrje totale neto	% të PBB	4.6	3.1	3.5	3.0	2.0	2.3	2.3
Borxhi Publik Total	% të PBB	59.4	58.5	59.4	59.9	59.9	59.9	59.6
<i>Borxhi publik i qeverise se pergjithshme</i>	% të PBB	55.5	54.8	55.6	56.2	55.5	55.1	54.8
<i>Borxhi publik jashte treguesve fiskale</i>	% të PBB	4.0	3.7	3.7	3.8	4.4	4.8	4.8
Llogaria korente	% të PBB	-15.2	-11.5	-12.4	-11.3	-10.6	-9.4	-8.3
Bilanci i mallrave	% të PBB	-26.4	-23.5	-24.2	-22.7	-21.4	-19.9	-19.1
Bilanci i shërbimeve	% të PBB	2.0	2.6	1.5	2.7	2.7	2.6	3.4
Bilanci i Pagesave	% të PBB	-0.3	2.0	-0.3	1.8	1.9	2.1	2.0

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave

Lidhja Nr. 2/1

TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR
ne milion Leke

Nr.	E M E R T I M I	2009	2010	2011	2012		2013		2014		2015	
					I Pritshmi	PBA	PBA	PBA	PBA	PBA		
	TOTALI TE ARDHURAVE	298,981	324,721	330,469	344,065	357,281	376,144	396,638				
I.	Ndihmat	4,430	4,605	3,811	5,422	5,750	6,107	6,479				
II.	Te ardhura tatimore	270,870	288,564	303,927	314,443	330,732	348,574	367,026				
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	208,870	223,019	235,509	242,176	255,154	269,264	283,725				
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	110,062	113,998	119,189	122,384	128,590	135,221	142,589				
2	Tatimi mbi Fitimin	17,149	17,606	19,712	15,089	15,880	16,726	17,616				
3	Akczizat	33,504	38,788	40,403	41,074	43,177	45,561	48,120				
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	26,820	27,058	27,967	27,840	29,328	30,861	32,473				
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	13,405	18,295	21,388	29,863	32,086	34,675	36,599				
6	Taksa Doganore	7,929	7,274	6,850	5,926	6,095	6,219	6,328				
II.2	Te ardhura nga Pushteti Lokal	12,149	11,898	11,791	12,441	13,260	14,074	14,938				
1	Taksa lokale	8,154	7,684	7,279	7,286	7,723	8,233	8,752				
2	Tatimi mbi Pasurine (ndertesat)	1,509	1,896	1,942	2,699	2,942	3,119	3,328				
3	Tatimi mbi Biznesin e vogel	2,486	2,318	2,570	2,456	2,594	2,722	2,859				
II.3	Te ardhura nga fondet speciale	49,812	53,647	56,627	59,826	62,318	65,236	68,362				
1	Sigurimi Shoqeror	44,344	45,041	48,839	49,447	51,892	54,450	57,184				
2	Sigurimi Shendetsor	5,467	6,432	6,152	8,879	9,327	9,786	10,278				
3	Te ardhurat per kompensimin ne vlore te pronareve	0	2,174	1,636	1,500	1,100	1,000	900				
III.	Te ardhura jostatimore	23,720	31,552	22,731	24,201	20,799	21,464	23,133				
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	6,241	4,936	5,710	4,500	4,500	4,500	4,600				
2	Te ardhura nga Inst.Buxhetore nga te cilat:	9,338	13,994	10,336	12,701	12,999	14,164	15,733				
	Te ardhura nga sistemi i arsimit te larte				2,800	3,000	3,150	3,308				
	Te ardhura jostatimore te pushtetit vendor				2,000	2,300	2,415	2,536				
	Shifja e Hidrocentralit te Lana-Bregasit				2,000	0	0	0				
	Shifja e licencave 3G				1,000	0	0	0				
	Te tjera te ardhura nga Inst. Buxhetore				4,901	7,699	8,599	9,890				
3	Dividenti	374	735	1,060	300	300	300	300				
4	Tarifat sherbimeve	4,183	2,977	3,510	3,900	1,500	1,000	1,000				
5	Te tjera nga te cilat:	3,584	8,910	2,115	2,800	1,500	1,500	1,500				
	Rezultati financiar i ISSH				500	0	0	0				
	Te tjera jashte limitit				1,300	1,400	1,400	1,400				
	TOTALI I SHPENZIMEVE	379,863	362,752	376,300	385,229	386,270	410,677	432,907				
I.	Shpenzime Korrente	283,898	300,878	305,621	318,346	332,722	349,861	368,726				
I.1	Personeli	62,359	65,762	67,448	70,666	72,627	75,275	78,309				
1	Paga	53,272	56,951	58,398	58,535	60,715	62,936	65,375				
2	Kontributi per Sigurime Shoqerore	9,087	8,811	9,048	9,400	9,712	10,039	10,435				
3	Fondi i vecante i pagave	0	0	0	1,731	1,200	1,300	1,500				
4	Politikat e reja pagash	0	0	0	1,000	1,000	1,000	1,000				
I.2	Interesat	36,301	41,604	41,121	47,100	49,884	53,887	57,528				
1	Te brendshme	31,408	35,583	34,253	37,500	39,130	41,260	43,760				
2	Te Huaja	4,893	6,021	6,868	9,600	10,754	12,627	13,768				
I.3	Shpenzime Operative Mirembajtje nga te cilat:	32,058	34,318	32,995	28,502	29,755	30,630	32,122				
	Arsim i larte				2,200	2,200	2,363	2,481				
	Te tjera jashte limitit				1,300	1,400	1,400	1,400				
I.4	Subvencionet	2,004	3,535	3,301	1,600	1,600	1,500	1,500				
I.5	Shpenzime per Sig.Sociale dhe transferime te tjera	96,725	106,207	113,894	121,799	128,243	135,650	143,693				
1	Sigurime Shoqerore	73,744	79,316	85,265	89,565	95,000	101,000	107,500				
2	Politika te reja pensionesh	0	0	0	1,500	1,500	1,500	1,500				
3	Sigurime Shendetsore	22,980	25,141	26,974	28,934	30,443	31,850	33,393				
4	Shpenzime per Kompensimin ne Vlore te Pronareve	0	1,750	1,655	1,800	1,300	1,300	1,300				
I.6	Buxheti lokal	33,583	30,764	28,119	28,920	30,513	32,119	33,774				
1	Buxheti lokal (Granti) nga i cili:	21,434	18,866	16,328	13,876	14,153	14,630	15,200				
	Grante konkurrese				2,300	2,000	2,500	2,500				
2	Buxheti lokal (Te ardhurat e veta tatimore)	12,149	11,898	11,791	12,441	13,260	14,074	14,938				
3	Buxheti lokal (Te ardhurat nga transferimi i rentes)				603	800	1,000	1,100				
4	Buxheti lokal (Te ardhurat e veta jo-tatimore)				2,000	2,300	2,415	2,536				
I.7	Shpenzime te tjera	20,867	18,688	18,745	19,759	20,100	20,800	21,800				
1	Pagesa e papunesise	868	982	876	1,000	1,000	1,000	1,100				
2	Ndihma Ekonomike	16,060	16,706	16,369	17,059	17,400	18,000	18,700				
3	Kompensim per te perndjekurit politike	2,200	1,000	1,500	1,700	1,700	1,800	2,000				
II.	Fondi Rezerve	0	0	0	3,700	4,500	7,000	10,500				
III.	Shpenzime Kapitale	95,881	67,492	70,679	63,183	49,048	53,816	53,681				
1	Financimi Brendshem nga I cili:	75,600	46,642	41,097	25,233	7,900	8,589	12,652				
	Arsim i larte nga te ardhurat e veta				700	800	788	827				
2	Financimi Huaj	20,281	20,850	27,982	37,950	41,148	45,227	41,029				
IV.	Transferta te ndryshme	85	-5,618	0	0	0	0	0				
	DEFICITI	-80,883	-38,031	-45,831	-41,163	-28,989	-34,533	-36,268				
	FINANCIMI DEFICITIT	80,883	38,031	45,831	41,163	28,989	34,533	36,269				
I.	Brendshem	70,701	13,155	26,073	18,815	6,723	15,136	24,858				
1	Te ardhura nga Privatizimi	25,138	411	438	1,000	0	0	0				
2	Hua-marje e brendeshme	43,339	11,284	28,175	17,815	6,723	15,136	24,858				
3	Te tjera	2,224	1,460	-2,539	0	0	0	0				
II.	I Huaj	10,182	24,876	19,758	22,348	22,266	19,397	11,411				
1	Hua afatgjate(e marre)	15,375	59,793	25,229	32,528	35,398	39,120	78,200				
2	Ndryshimi i gjendjes se arkës	567	-1,705	2,142	0	0	0	0				
3	Ripagesat	-5,760	-33,212	-7,613	-10,180	-13,132	-19,723	-66,789				
	MEMO:											
	Borxhi Publik Total (Stok)	682,403	715,475	772,615	815,795	856,808	899,582	939,399				
I.	Borxhi publik nga buxheti (stock)	636,629	670,049	724,299	764,463	793,452	827,985	864,253				
1	I Brendshem (stock)	409,501	401,821	429,924	447,739	454,462	469,598	494,456				
2	I Huaj (stock), nga i cili:	227,128	268,228	294,375	316,723	338,989	358,386	369,797				
	Pushteti Vendor (stock)	0	147	252	349	1,500	1,500	1,500				
II.	Borxhi publik jashte buxhetit (stok)	45,774	45,425	48,316	51,332	63,356	71,597	75,146				
1	Borxhi publik i garantuar (stok)	45,774	45,425	48,316	46,172	48,374	45,039	41,566				
2	Borxhi nga disbursimet jashte buxhetit (stok)				3,659	7,607	13,014	13,729				
3	Provizion per rishikim nga kursi i kombimit (flow)				1,501	5,874	6,168	6,308				
	PBB nominal	1,148,082	1,222,462	1,301,750	1,360,914	1,430,920	1,501,456	1,576,866				

Burimi: Ministria e Financave



Lidhja Nr. 2/2

TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR në % te Produktit te Brendshem Bruto

Nr.	E M E R T I M I	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
					I Pritshmi	PBA	PBA	PBA
TOTALI TE ARDHURAVE		26.0	26.6	25.4	25.3	25.0	25.1	25.2
I.	Ndihmat	0.4	0.4	0.3	0.4	0.4	0.4	0.4
II.	Te ardhura tatimore	23.6	23.6	23.3	23.1	23.1	23.2	23.3
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	18.2	18.2	18.1	17.8	17.8	17.9	18.0
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	9.6	9.3	9.16	9.0	9.0	9.0	9.0
2	Tatimi mbi Fitimin	1.5	1.4	1.5	1.1	1.1	1.1	1.1
3	Akcizat	2.9	3.2	3.1	3.0	3.0	3.0	3.1
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	2.3	2.2	2.1	2.0	2.0	2.1	2.1
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	1.2	1.5	1.6	2.2	2.2	2.3	2.3
6	Taksa Doganore	0.7	0.6	0.5	0.4	0.4	0.4	0.4
II.2	Te ardhura nga Pushteti Lokal	1.1	1.0	0.9	0.9	0.9	0.9	0.9
1	Taksa lokale	0.7	0.6	0.6	0.5	0.5	0.5	0.6
2	Tatimi mbi Pasurine(ndertesat)	0.1	0.2	0.1	0.2	0.2	0.2	0.2
3	Tatimi mbi Biznesin e vogel	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
II.3	Te ardhura nga fondet speciale	4.3	4.4	4.4	4.4	4.4	4.3	4.3
1	Sigurimi Shoqeror	3.9	3.7	3.8	3.6	3.6	3.6	3.6
2	Sigurimi Shendetesor	0.5	0.5	0.5	0.7	0.7	0.7	0.7
3	Te ardhurat per kompensimin ne vlera te pronareve	0.0	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
III.	Te ardhura jotatimore	2.1	2.6	1.7	1.8	1.5	1.4	1.5
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	0.5	0.4	0.4	0.3	0.3	0.3	0.3
2	Te ardhura nga Inst.Buxhetore nga te cilat:	0.8	1.1	0.8	0.9	0.9	0.9	1.0
	Te ardhura nga sistemi i arsimit te larte	0.0	0.0	0.0	0.2	0.2	0.2	0.2
	Te ardhura jotatimore te pushtetit vendor	0.0	0.0	0.0	0.1	0.2	0.2	0.2
	Shitja e Hidrocentralit te Lana-Bregasit	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0
	Shitja e licencave 3G	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0
	Te tjera te ardhura nga Inst. Buxhetore	0.0	0.0	0.0	0.4	0.5	0.6	0.6
3	Dividenti	0.0	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
4	Tarifat sherbimeve	0.4	0.2	0.3	0.3	0.1	0.1	0.1
5	Te tjera nga te cilat:	0.3	0.7	0.2	0.2	0.1	0.1	0.1
	Rezultati financiar i ISSH	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Te tjera jashte limitit	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
TOTALI I SHPENZIMEVE		33.1	29.7	28.9	28.3	27.0	27.4	27.5
I.	Shpenzime Korrente	24.7	24.6	23.5	23.4	23.3	23.3	23.4
I.1	Personeli	5.4	5.4	5.2	5.2	5.1	5.0	5.0
1	Paga	4.6	4.7	4.5	4.3	4.2	4.2	4.1
2	Kontributi per Sigurime Shoqerore	0.8	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7
3	Fondi i vecante i pagave	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
4	Politikat e reja pagash	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
I.2	Interesat	3.2	3.4	3.2	3.5	3.5	3.6	3.6
1	Te brendshme	2.7	2.9	2.6	2.8	2.7	2.7	2.8
2	Te Huaja	0.4	0.5	0.5	0.7	0.8	0.8	0.9
I.3	Shpenzime Operative Mirembajtje nga te cilat:	2.8	2.8	2.5	2.1	2.1	2.0	2.0
	Arsim i larte							
	Te tjera jashte limitit							
I.4	Subvencionet	0.2	0.3	0.3	0.1	0.1	0.1	0.1
I.5	Shpenzime per Sig.Sociale dhe transferime te tjera	8.4	8.7	8.7	8.9	9.0	9.0	9.1
1	Sigurime Shoqerore	6.4	6.5	6.6	6.6	6.6	6.7	6.8
2	Politika te reja pensionesh	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
3	Sigurime Shendetesore	2.0	2.1	2.1	2.1	2.1	2.1	2.1
4	Shpenzime per Kompensimin ne Vlera te Pronareve	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
I.6	Buxheti lokal	2.9	2.5	2.2	2.1	2.1	2.1	2.1
1	Buxheti lokal (Granti) nga i cili:	1.9	1.5	1.3	1.0	1.0	1.0	1.0
	Grante konkurruese	0.0	0.0	0.0	0.2	0.1	0.2	0.2
2	Buxheti lokal (Te ardhurat e veta tatimore)	1.1	1.0	0.9	0.9	0.9	0.9	0.9
3	Buxheti lokal (Te ardhurat nga transferimi i rentes)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1
4	Buxheti lokal (Te ardhurat e veta jo-tatimore)	0.0	0.0	0.0	0.1	0.2	0.2	0.2
I.7	Shpenzime te tjera	1.8	1.5	1.4	1.5	1.4	1.4	1.4
1	Pagesa e papunesise	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
2	Ndihma Ekonomike	1.4	1.4	1.3	1.3	1.2	1.2	1.2
3	Kompensim per te permdjekurit politike	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
II.	Fondi Rezerve	0.0	0.0	0.0	0.3	0.3	0.5	0.7
1	Fondi Rezerve i Keshillit te Ministrave	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
2	Fond Kontigjence per ruajtjen e deficitit	0.0	0.0	0.0	0.2	0.2	0.4	0.5
III.	Shpenzime Kapitale	8.4	5.5	5.4	4.6	3.4	3.6	3.4
1	Financimi Brendshem nga I cili:	6.6	3.8	3.2	1.9	0.6	0.6	0.8
	Arsim i larte nga te ardhurat e veta							
2	Financimi Huaj	1.8	1.7	2.1	2.8	2.9	3.0	2.6
IV.	Transferta te ndryshme	0.0	-0.5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
DEFICITI		-7.0	-3.1	-3.5	-3.0	-2.0	-2.3	-2.3
FINANCIMI DEFICITIT		7.0	3.1	3.5	3.0	2.0	2.3	2.3
I.	Brendshem	6.2	1.1	2.0	1.4	0.5	1.0	1.6
1	Te ardhura nga Privatizimi	2.2	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0
2	Hua-marje e brendeshme	3.8	0.9	2.2	1.3	0.5	1.0	1.6
3	Te tjera	0.2	0.1	-0.2	0.0	0.0	0.0	0.0
II.	I Huaj	0.9	2.0	1.5	1.6	1.6	1.3	0.7
1	Hua afatgjate(e marre)	1.3	4.9	1.9	2.4	2.5	2.6	5.0
2	Ndryshimi i gjendjes se arkës	0.0	-0.1	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0
3	Ripagesat	-0.5	-2.7	-0.6	-0.7	-0.9	-1.3	-4.2
MEMO:								
Borxhi Publik Total (Stok)		59.4	58.5	59.4	59.9	59.9	59.9	59.6
I.	Borxhi publik nga buxheti (stock)	55.5	54.8	55.6	56.2	55.5	55.1	54.8
II.	Borxhi publik jashte buxhetit (stok)	4.0	3.7	3.7	3.8	4.4	4.8	4.8
1	Borxhi publik i garantuar (stok)	4.0	3.7	3.7	3.4	3.4	3.0	2.6
2	Borxh nga disbursimet jashte buxhetit (stok)				0.3	0.5	0.9	0.9
3	Provizioni per riskun nga kursi i kembimit (flow)				0.1	0.4	0.4	0.4
PBB nominal		100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Ministria e Financave

VENDIM
Nr. 545, datë 16.8.2012

**PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE, BURSAT E SHTETIT
DHE PAGESAT E NXËNËSVE E TË STUDENTËVE NË INSTITUCIONET ARSIMORE
PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR 2012 -2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 57 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 1 e 5 të ligjit nr. 10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 29 të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimim dhe formim profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nxënësit që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike dhe studentët që ndjekin një program studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, në institucionet arsimore publike, mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

2. Përfitojnë bursë nxënësit dhe studentët, brenda kuotave dhe kriterëve të përcaktuara në këtë vendim:

2.1 Sipas kriterit ekonomik (nxënës/studentë):

a) nxënësit/studentët që vazhdojnë studimet larg vendbanimit të tyre në largësinë mbi 5 km dhe plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) nxënësit që banojnë në fshat, të cilët nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km e që vendosen në konvikt publik;

c) nxënësit/studentët që kanë përfitur statusin e jetimit dhe që plotësojnë kriterin ekonomik;

ç) nxënësit/studentët të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë dhe që plotësojnë kriterin ekonomik;

d) secili nga studentët bashkëshort me fëmijë, që plotëson kriterin ekonomik dhe që vendoset në konvikt publik;

dh) fëmijët, nxënës apo studentë, që kanë statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik dhe që plotësojnë kriterin ekonomik.

2.2 Sipas rezultateve të arritura (nxënës/studentë):

a) nxënësit e arsimit të mesëm profesional, që kanë mbaruar vitin shkollor pararendës me të gjitha notat 10 (dhjeta);

b) nxënësit, të cilët vazhdojnë studimet në shkollat profesionale, në degët bujqësore, veterinarë, pyjore dhe ndërtim, në vitet e dyta e lart, dhe që kanë mbaruar vitin akademik pararendës me notën mesatare mbi 8 (tetë);

c) studentët që regjistrohen në vitin e parë të shkollës së lartë, që kanë mbaruar shkollën e mesme me medalje ari;

ç) studentët që regjistrohen në vitin e parë të shkollës së lartë, që janë shpallur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës më të mirët e Maturës Shtetërore, sipas renditjes në listën e vlerësimit, të realizuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve. Për vitin akademik 2012-2013, numri i tyre do të jetë 25 (njëzet e pesë) studentë. Kjo kategori studentësh përfiton bursë kur ata vazhdojnë studimet në institucionet e arsimit të lartë publik dhe vetëm për vitin akademik 2012-2013;

d) studentët që kanë mbaruar vitin akademik pararendës me të gjitha notat 10 (dhjeta);



dh) studentët që vazhdojnë studimet në programin e studimit “Matematikë” dhe në programin e studimit “Fizikë”, në vitin e dytë e lart, dhe kanë mbaruar vitin akademik pararendës me notën mesatare mbi 8 (tetë).

2.3 Jashtë kriterit ekonomik (nxënës/studentë):

- Nxënës apo studentë, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.

Në fillim të çdo viti akademik, Ministria e Brendshme, Shërbimi Informativ Shtetëror, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Mbrojtjes dërgojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listën për këtë kategori nxënësish/studentësh.

2.4 Sipas degëve prioritare për zhvillimin e ekonomisë (nxënës):

- Nxënësit që regjistrohen në shkollat e mesme profesionale në degët bujqësore, veterinare, pyjore, ndërtim dhe teknologji informacioni.

Nxënësit me vendbanim të përhershëm në zonat verilindore dhe juglindore të vendit: Tropoja, Hasi, Puka, Kukësi, Dibra, Bulqiza, Mati, Mirdita, Malësia e Madhe, Librazhdi, Gramshi, Kolonja, Përmeti, Pogradeci, Skrapari dhe rrethi Tepelenë, kanë përparësi në trajtimin me bursë.

3. Nxënësit dhe studentët e të gjitha kategorive të mësipërme, nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të saj, kur:

- a) janë ndarë nga trangu familjar;
- b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;
- c) vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi;
- ç) shpallen ngelës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokalue.

4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës harton planin e shpërndarjes së bursave, për drejtoritë arsimore rajonale (DAR) dhe zyrat arsimore (ZA), për vitet e para, sipas kuotave të miratuara (për nxënës/studentë). DAR/ZA-të, pas këshillimit me njësitë e pushtetit vendor, hartojnë planin e shpërndarjes së bursave dhe e dërgojnë në njësitë e pushtetit vendor (bashki/komunë), në përshtatje me kërkesat e paraqitura paraprakisht prej tyre për kategoritë, sipas pikës 2.1.

5. Bashkitë dhe komunat, bazuar në planin e përcaktuar për to nga DAR/ZA-të, vendosin, me këshillat e tyre, për dhënien e bursave, sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të këtij vendimi, duke u dhënë përparësi nxënësve dhe studentëve nga shtresat sociale në nevojë, për trajtimin me bursë të plotë ose, në pamundësi, trajtimin me gjysmë bursë.

5.1 Bashkitë dhe komunat, detyrimisht, duhet t’u dërgojnë, në rrugë zyrtare, drejtorive arsimore rajonale apo zyrave arsimore përkatëse vendimet për dhënien e bursave, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

5.2 Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore duhet të dërgojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, si dhe bashkive/komunave që menaxhojnë konviktet, listën emërore të studentëve dhe të nxënësve bursistë, së bashku me vendimet origjinale të këshillave të bashkive dhe të këshillave të komunave. Një kopje e listës emërore të studentëve dhe nxënësve të trajtuar me bursë dërgohet edhe në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

5.3 Plani i bursave për nxënësit që regjistrohen dhe vazhdojnë studimet në vitin e parë shkollor 2012-2013, në shkollat profesionale, në degët bujqësore, veterinare, pyjore, ndërtim dhe teknologji informacioni, jepet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), për bashkinë dhe komunën përkatëse, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve ku janë vendosur nxënësit, sipas numrit të nxënësve të regjistruar në këto degë, brenda numrit të përgjithshëm të bursave të dhëna për vitin shkollor 2012-2013. Drejtoria arsimore rajonale dhe zyra arsimore, menjëherë, me mbarimin e regjistrimit në këto degë, dërgojnë informacion në MASH për numrin e nxënësve të regjistruar.

6. Bursat e nxënësve për vitin e dytë e lart, rishqyrtohen dhe miratohen, çdo vit, nga këshilli i bashkisë dhe i komunës, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve ku janë vendosur nxënësit konviktorë. Drejtoritë arsimore rajonale paraqesin/dërgojnë zyrtarisht në njësitë

vendore kërkesat për miratim burse për nxënësit që përfitojnë bursë sipas shkronjave “a”, “b” e “c” të pikës 2.2 të këtij vendimi.

Nxënësit që vitin e parë kanë përfitur bursë me vendim të këshillit të bashkisë apo komunës, ku ata kanë vendbanimin e përhershëm, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit, nëse atyre nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës.

6.1 Gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës profesionale, nxënësve që kanë përfitur bursë u paguhet bursa paradhënie nga njësia e qeverisjes vendore, me fillimin e praktikës mësimore, në llogarinë bankare të nxënësit/prindit përfitues, pranë bankave të nivelit të dytë apo në zyrat e Postës Shqiptare. Drejtorët e shkollave profesionale e social-kulturore dërgojnë zyrtarisht, çdo muaj, pranë njësite të qeverisjes vendore, informacion për frekuentimin e shkollës/praktikës profesionale për nxënësit që përfitojnë bursë.

6.2 Nxënësit e klasës së 12-të të shkollës së mesme “Nazmi Rushiti”, Dibër, dhe nxënësit e klasës së 12-të të shkollës së mesme “Havzi Nela”, Kukës, të cilët transferojnë programet e nivelit të dytë në shkollat e mesme profesionale, Shkodër, pra nga njësitë vendore bashkia Peshkopi dhe bashkia Kukës në njësinë vendore bashkia Shkodër, njëkohësisht transferojnë, zyrtarisht, në bashkinë Shkodër, numrin e bursave (listën e nxënësve), që kanë përfitur bursë për vitin shkollor 2011-2012.

6.3 Për nxënësit e tjerë të klasës së 12-të të shkollës së mesme “Nazmi Rushiti”, Dibër, dhe nxënësit e klasës së 12-të të shkollës së mesme “Havzi Nela”, Kukës, që plotësojnë kriteret ekonomike dhe kriterin e largësisë nga vendbanimi sipas pikës 2.1 “Sipas kriterit ekonomik”, kërkesat e tyre shqyrtohen dhe trajtohen me bursë nga njësia e qeverisjes vendore, bashkia Shkodër.

7. Bursat e studentëve, për vitin e dytë e lart, rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit nga institucionet publike të arsimit të lartë. Studentët e vitit të dytë e lart, që nuk kanë përfitur bursë dhe plotësojnë kriterin ekonomik, mund të përfitojnë bursë brenda numrit të planit të bursave, të përcaktuara sipas këtij vendimi.

7.1 Numri i bursave për këtë kategori studentësh dhe për studentët që përfitojnë bursë, sipas pikës 2.2, është deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) në shkallë vendi, brenda numrit të përgjithshëm të bursave të dhëna për vitin akademik 2012-2013. Institucionet publike të arsimit të lartë paraqesin në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës kërkesat për studentët që përfitojnë bursë sipas shkronjave “ç”, “d” e “dh” të pikës 2.2 të këtij vendimi.

7.2 Ministria e Arsimit dhe Shkencës harton planin e shpërndarjes dhe e dërgon për ekzekutim në institucionet publike të arsimit të lartë. Studentët që vitin e parë kanë përfitur bursë, me vendim të këshillit të bashkisë apo komunës, ku kanë vendbanimin e përhershëm, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit, nëse atyre nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës.

8. Nga plani i bursave të miratuara për vitin akademik 2012 -2013, bashkisë së Tiranës i jepen deri 15 (pesëmbëdhjetë) bursa për studentët të cilët, pavarësisht nga kriteri i vendbanimit apo kriteret ekonomike, kanë statusin ligjor të jetimit, si dhe statusin e invalidit paraplegjik apo tetraplegjik, ndërsa bashkive të tjera, të cilat në vendndodhjen e tyre territoriale kanë institucione të arsimit të lartë publik, për këtë kategori studentësh, u jepen deri në 5 (pesë) bursa.

9. Nxënësit dhe studentët që kanë përfitur statusin e jetimit, nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë përfitojnë falas veshmbathje, libra dhe fletore, sipas pasqyrës nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë përjashtohen nga detyrimet e tarifave të shërbimeve të ndryshme që ofrojnë shkollat.

9.1 Nxënësve dhe studentëve që kanë përfitur statusin e jetimit, u sigurohen falas, nga fondet e shkollave përkatëse, shërbimi shëndetësor, shërbimi dentar dhe medikamentet pas paraqitjes së librezës e të kartës shëndetësore, si dhe të epikrizës, nga qendra spitalore e rrethit.

9.2 Nxënësit jetimë që vazhdojnë shkollat e mesme a të larta, për periudhën e pushimeve verore, trajtohen me pagesë suplementare që përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, si dhe vetëm një vit, kur humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokalue, nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale.



9.3 Fëmijët/nxënësit dhe mësuesit e institucioneve të arsimit special, pa konvikt, trajtohen falas nga shteti me një vakt ushqim (drekë), me vlerë deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë në ditë.

10. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat dhe numri i bursave për studentët administrohen nga institucionet publike të arsimit të lartë. Bursat përlllogariten shpenzime mesatare në ditë dhe paguhen çdo muaj me kalim në numrin e llogarisë bankare të çdo studenti. Drejtuesit e fakulteteve dërgojnë zyrtarisht, çdo muaj, pranë njësive/departamentit të financës, të dhëna për frekuentimin e shkollës për studentët që përfitojnë bursë.

10.1 Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat dhe numri i bursave për nxënësit administrohen nga bashkia e komuna, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve ku janë vendosur nxënësit konviktorë. Masa mujore e bursës u jepet nxënësve në formën e kuotës ushqimore, në konvikt.

10.2 Nxënësve, të cilët për mungesë kapacitetesh nuk janë vendosur/akomoduar në konvikt, bursa u paguhet çdo muaj nga bashkia/komuna, në llogarinë bankare të nxënësit/prindit përfitues, pranë bankave të nivelit të dytë apo në zyrat e Postës Shqiptare. Drejtorët e shkollave profesionale e social-kulturore dërgojnë zyrtarisht çdo muaj pranë njësive të qeverisjes vendore, informacion për frekuentimin e shkollës për nxënësit që përfitojnë bursë.

11. Niveli/masa e bursës, për nxënësit dhe studentët, jepet sipas pasqyrave nr. 2 e nr. 3 dhe kuota financiare ushqimore ditore jepet sipas pasqyrave nr. 4 e nr. 5, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

12. Ministria e Arsimit dhe Shkencës për vitin e ri akademik 2012-2013, të japë 1650 (një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) bursa për nxënësit dhe 1900 (një mijë e nëntëqind) bursa për studentët, për hyrjet e reja në vitin e parë në sistemin arsimor publik për të gjitha kategoritë e parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi.

13. Efektet financiare për vitin akademik 2012-2013 të përballohen nga fondet e Buxhetit të Shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për vitin 2012, për pjesën e vitit 2012, si dhe nga fondet e Buxhetit të Shtetit që do të miratohet për vitin 2013, për pjesën e vitit 2013.

14. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për vitet e para, është data 15 dhjetor 2012, për të gjitha kategoritë e shkollave, ndërsa për vitin e dytë e lart është data 15 nëntor 2012.

15. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, për raste të veçanta, kur vendimet e këshillave të njësive të qeverisjes vendore dërgohen jashtë afatit të përcaktuar në këtë vendim, ka të drejtë të shqyrtojë dhe të rivendosë në afat përfitimin e bursës për nxënësin/studentin.

16. Vendimet e njësive të qeverisjes vendore dhe ato të institucioneve publike të arsimit të lartë publikohen për komunitetin, median dhe institucionet e tjera vendore apo qendrore.

17. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, DAR/ZA-të, institucionet publike të arsimit të lartë dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Pasqyra nr.1:**KUSHTET EKONOMIKE TË NXËNËSIT DHE STUDENTIT PËR DHËNIEN E BURSËS (VITI MËSIMOR 2012- 2013)**

Nr.	Përbërja familjare	Përfitojnë bursa	Përfitojnë gjysmë bursa	Me pagesë
	Për qytetin	Me të ardhura mujore lekë/frymë	Me të ardhura mujore lekë/frymë	Me të ardhura mujore lekë/frymë
1	Për familjet me 2 persona	Deri 3,200	3,200-4,600	Mbi 4,600
2	Për familjet me 3 persona	Deri 3,100	3,100-4,500	Mbi 4,500
3	Për familjet me 4 persona	Deri 3,000	3,000-4,400	Mbi 4,400
4	Për familjet me 5 persona	Deri 2,900	2,900-4,300	Mbi 4,300
5	Për familjet me 6 persona	Deri 2,800	2,800-4,200	Mbi 4,200
6	Për familjet me 7 persona	Deri 2,700	2,700-4,100	Mbi 4,100
7	Për familjet me 8 persona	Deri 2,600	2,600-4,000	Mbi 4,000

Shënim. Nxënësit dhe studentët nga fshati përfitojnë bursë, kur familja përfiton ndihmë ekonomike, në varësi të masës së kësaj ndihme, brenda planit të akorduar për secilën njësi të pushtetit vendor.

Pasqyra nr.2 NIVELI I BURSËS PËR NXËNËSIT (VITI MËSIMOR 2012- 2013) Në lekë

Nr.	Kategoritë e bursave sipas shkollave	Kuotat e bursës			Financimi nga nxënësi	Financimi nga shteti
		Për kuotë ushqimi	Shpenzime vetjake	Totali i kuotës		
1	Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme					
	a) Bursa	6,165	200	6,365	0	6,365
	b) Gjysmë bursa	6,165	200	6,365	3,182	3,183
	c) Me pagesë	6,165	200	6,365	6,365	0
2	Shkolla e Mjeshtërisë Sportive dhe Arsimit Special					
	a) Bursa	6,683	200	6,883	0	6,883
	b) Gjysmë bursa	6,683	200	6,883	3,441	3,442
	c) Me pagesë	6,683	200	6,883	6,663	0
3	Nxënësit jetimë	6,683	200	6,883	0	6,883

Pasqyra nr.3: NIVELI I BURSËS PËR STUDENTËT (VITI MËSIMOR 2012- 2013) Në lekë

Nr.	Kategoritë e bursave sipas shkollave	Kuotat e bursës			Financimi nga studenti	Financimi nga shteti
		Për kuotë ushqimi	Shpenzime vetjake	Totali i kuotës		
1	Universitetet, Akademia e Arteve dhe shkollat e tjera të larta					
	a) Bursa	6,900	2,000	8,900	0	8,900
	b) Gjysmë bursa	6,900	2,000	8,900	4,450	4,450
	c) Me pagesë	6,900	2,000	8,900	8,900	0
2	Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve					
	a) Bursa	7,410	2,000	9,410	0	9,410
	b) Gjysmë bursa	7,410	2,000	9,410	4,705	4,705
	c) Me pagesë	7,410	2,000	9,410	9,410	0



Pasqyra nr.4 :

KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E NXËNËSVE VITI MËSIMOR 2012-2013.

Nr.	EMERTIMI	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar	Vlera ditore
1	Bukë	gram	350-400	977	100	35
2	Makarona	gram	30	107	120	3.6
3	Oriz	gram	30	109	150	4.5
4	Sheqer	gram	40	157	100	4
5	Fasule	gram	30	93	150	4.5
6	Perime	gram	130	27	100	13
7	Fruta	gram	100	42	100	10
8	Vaj	gram	30	270	234	7
9	Gjalpë	gram	20	152	531	11
10	Mish	gram	75-80	115	750	58
11	Djathë	gram	25	40	300	7
12	Reçel	gram	20	93	250	5
13	Vezë	kokërr	1	42	8	8
14	Qumësht	gram	200	98	80	16
15	Patate	gram	200	170	40	8
16	Nënprodukte mishi	gram	30	100	400	12
	Kuota ditore			2712		206

Shënim. Çmimi mesatar është indeksuar me normën mesatare të inflacionit, viti 2010. Është e domosdoshme që nxënësi të marrë kuotën ditore në lekë dhe në kalori, ndërsa gramaturat dhe lloji i ushqimit mund të ndryshojnë sipas menyre të ndryshme, sipas çmimeve që ofrohen nga konkurrenca e prokurimeve dhe ndikimit të faktorëve të tjerë (gramaturat e normës ditore në pasqyrë janë përdorur për efekt planifikimi).

Pasqyra nr.5 : KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E STUDENTËVE (VITI MËSIMOR 2012 -2013)

Nr.	EMERTIMI	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar në lekë/kg	Vlera ditore
1	Bukë	gram	400	1,117	100	40
2	Makarona	gram	30	107	120	3.6
3	Oriz	gram	40	145	150	4.5
4	Sheqer	gram	40	157	100	4
5	Fasule	gram	40	124	150	4.5
6	Perime	gram	130	27	100	13
7	Fruta	gram	100	42	100	10
8	Vaj	gram	40	360	234	7
9	Gjalpë	gram	20	152	531	11
10	Mish	gram	98	140	750	67.5
11	Djathë	gram	42	66	400	10
12	Reçel	gram	44	190	350	7
13	Patate	gram	200	170	12	12
14	Qumësht	gram	200	98	80	16
